



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

### V E N D I M Nr. 8, datë 27.12.2018

#### MBI NISJEN E PROCEDURAVE PER EMËRIMIN E TË DIPLOMUARVE NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2018

Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur më datë 27.12.2018, mbështetur në nenet 32 dhe 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në dokumentacionin e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës me shkresat nr. 2676 prot., datë 02.07.2018 dhe nr. 935 prot., datë 26.12.2018,

#### V E N D O S I:

1. Të fillojë procesin e emërimit të kandidatëve për magjistratë të cilët janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018 duke kërkuar raport për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve për magjistrat, nga institucionet kompetente parashikuar në nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**